

Raporti për azilin, 2026

Përmbledhje ekzekutive



Raporti për azilin, 2026

Raporti vjetor për gjendjen e azilit në
Bashkimin Evropian

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qershor 2026



© Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), 2026

As Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), as ndonjë person që vepron në emër të EUAA-së, nuk janë përgjegjës për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban ky botim.

Fotografia shoqëruese: Getty Images/[Stefano Guidi](#)

Luksemburg: Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, 2026

PDF BZ-01-26-013-SQ-N ISBN 978-92-9418-462-7 2600-3139 doi: 10.2847/0375333

Riprodhimi autorizohet me kusht që të cilësohet burimi. Për përdorimin ose riprodhimin e fotografive ose të materialeve të tjera për të cilat EUAA-ja nuk ka të drejta autori, duhet të merret leja drejtpërdrejt te zotëruesi i këtyre të drejtave.

Note: *This translation has not been verified by the EUAA.*

Parathënie

Për të dytin vit radhazi, numri i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare në vendet e BE+ ka pësuar rënie, me një numër total prej 0,8 milion kërkesash. Kjo ka ardhur si pasojë e një sërë faktorësh, duke përfshirë zhvillimet politike në vendet kryesore të origjinës, si Siria, si dhe bashkëpunimin evropian me shtetet partnere, gjë që ka ulur lëvizshmërinë nëpër rrugët e migracionit drejt Evropës. Paralelisht me këtë, vendet e BE+ kanë vijuar të ofrojnë mbrojtje të përkohshme për rreth 4,5 milionë persona të zhvendosur nga Ukraina, ku disa vende kanë mbajtur peshën më të madhe të kësaj përgjegjësie. Ndërkohë, kanë vijuar nismat për zgjidhje afatgjata që do të lehtësojnë përfundimin e mbrojtjes së përkohshme në mars të vitit 2027.



Një mision i përbashkët për të gjitha vendet e BE+ në vitin 2025 ishin përgatitjet për aktivizimin e Paktit për Migracionin dhe Azilin, duke filluar nga qershori i vitit 2026. Planet kombëtare të zbatimit dhe strategjitë kombëtare shërbyen si busull për reformat që do të vënë së shpejti në lëvizje sistemin e përmirësuar të azilit në Evropë.

Megjithatë, shtetet nuk kanë qenë të vetme në këtë proces. Komisioni Evropian, së bashku me Agjencitë e BE-së, ofruan udhëzime dhe mbështetje. Agjencia jonë kontribuoi në këto përpjekje në sajë të Programit të saj të dedikuar për Paktin, i cili dha një sërë rezultatesh. EUAA-ja ofroi mbështetje operationale për shtetet në terren, trajnoi profesionistët e azilit, ndër të tjera edhe përmes Akademisë së akredituar të EUAA-së, zhvilloi materiale teknike për të ndihmuar profesionistët në zbatimin e proceseve të harmonizuara dhe kreu analiza të situatave për udhëheqjen e politikave.

Në fakt, në rastin e situatës dinamike në Siri, EUAA-ja veprroi me shpejtësi për mbledhjen e informacionit mbi politikat dhe praktikën e vendeve të BE+ lidhur me kërkesit sirianë, ndërsa kërkimet mbi informacionin e vendit të origjinës (COI) gjeneruan informacione cilësore mbi zhvillimet në vend. Duke dhënë një panoramë të zbatimit të koncepteve të vendeve të sigurta në vendet e BE+, EUAA-ja kontribuoi gjithashtu në procesin legjislativ për miratimin e një liste të përbashkët në nivel BE-je të vendeve të sigurta të origjinës dhe rishikimin e konceptit të vendit të tretë të sigurt.

Është e qartë se qershori 2026 nuk do të shënojë përmbylljen, por thjesht një hap drejt një faze të re në zhvillimin e Sistemit të Përbashkët Evropian për Azilin (CEAS). Kjo fazë mund të kërkojë shumë njohuri të bazuara në praktikë. Në këtë proces, feedback-u i marrë nga zbatimi në praktikë i rregullave të reja do të udhëheqë përshtatjet që duhen bërë në nivelin operacional dhe atë politik. Përgjatë procesit, Agjencia jonë do të vijojë të mbështesë vendet dhe të ofrojë ekspertizën e saj për funksionimin efektiv të CEAS.

Nina Gregori
Drejtoreshë Ekzekutive
Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin



Përmbajtja

Parathënie.....	4
Hyrje	6
Zhvillimet kryesore në fushën e azilit në Bashkimin Evropian në vitin 2025.....	7
Menaxhimi i aksesit në mbrojtjen ndërkombëtare	9
Nismat për procedura azili më të thjeshtuara dhe të harmonizuara	10
Pritja e kërkuessve për mbrojtje ndërkombëtare	11
Përgjegjësia për një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.....	12
Qasja e harmonizuar për risistemimin dhe pranimin për motive humanitare	13
Të drejtat e përfituesve të mbrojtjes ndërkombëtare për përfshirje dhe riintegrim	14
Kutia 1. Mbrojtja e përkohshme për personat e zhvendosur nga Ukraina	16
Masat mbrojtëse ligjore për fëmijët dhe kërkuessit me nevoja të veçanta.....	17
Vërejtjet përfundimtare	19



Hyrje

Përmbledhje ekzekutive e [Raportit për azilin, 2026: Raporti vjetor për gjendjen e azilit në Bashkimin Evropian](#) përmbledh zhvillimet kryesore lidhur me mbrojtjen ndërkombëtare, të cilat paraqiten në raportin kryesor. Përmbledhja është e disponueshme në [31 gjuhë](#), duke përfshirë të gjitha gjuhët e BE-së, si dhe në shqip, arabisht, maqedonisht, rusisht, serbisht, turqisht dhe ukrainisht.

Informacioni që paraqitet në raportin kryesor mund të konsultohet përmes burimeve të ndryshme, praktike për përdoruesit:




- [Baza e të dhënave e zhvillimeve kombëtare për azilin](#) paraqet zhvillimet legislative, institucionale dhe të politikave, të cilat përshkruhen në raport. Përditësimet mund të kërkohen sipas vendit, temës, vitit dhe llojit të zhvillimit. Informacioni gjithashtu përmbledhet dhe paraqitet në një tabelë, sipas vendit dhe sipas fushës tematike, në një dokument PDF.
- Raporti paraqet një përzgjedhje të zhvillimeve jurisprudenciale bazuar në [Bazën e të dhënave të jurisprudencës së EUAA-së](#). Hiperlink-et brenda tekstit do t'i drejtojnë lexuesit te rasti specifik në bazën e të dhënave.
- Burimet e përdorura për përgatitjen e *Raportit për Azilin* gjenden në listën e referencave në fund të raportit. Ato gjenden gjithashtu në Bazën e të Dhënave për Mbrojtjen Ndërkombëtare në Evropë (DIP), te [Burimet](#), me funksione kërkimi dhe eksportimi.

Për përditësime mbi veprimtaritë e EUAA-së dhe mbështetjen për shtetet anëtare, shihni infografikat: <https://www.euaa.europa.eu/asylum-report-2026/section-10-euaa-support-2025>

Për zhvillimet kryesore sipas shtetit, shihni përmbledhjet për secilin shtet: <https://www.euaa.europa.eu/asylum-report-2026/country-overviews>

Additional resources to the Asylum Report 2026



Translations
in all EU
languages
and 7 non-EU
languages



Click on [Database on International Protection in Europe](#) to consult sources on asylum



Zhvillimet kryesore në fushën e azilit në Bashkimin Evropian në vitin 2025



Në vitin 2025, Evropa përjetoi një vit tranzicioni dhe një periudhë ristrukturimi që u karakterizua nga hartimi i strategjive dhe investimi në modernizimin e arkitekturës evropiane të azilit dhe migracionit, shoqëruar me një rënie të dukshme të numrit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare. Zbatimi i Paktit për Migracionin dhe Azilin u vu në qendër të politikëbërjes evropiane, me synimin për të sjellë rezultate konkrete sa më shpejt. Nismat u fokusuan në rritjen e efikasitetit të procedurave të azilit, adresimin e flukseve në kufijtë e jashtëm dhe rritjen e efektivitetit të kthimeve. Planet kombëtare të zbatimit kanë shërbyer si busull për kthimin e Paktit në një realitet funksional, ndërsa Komisioni Evropian ofroi ekspertizën e tij dhe burime financiare dhe agjencitë përkatëse të BE-së ofruan ndihmën e tyre për shtetet anëtare të BE-së, në mënyrë që sistemet e tyre kombëtare të azilit dhe pritjes të jenë gati deri në qershor të vitit 2026.

Në përpjekje për të zbatuar disa elemente të Rregullores për Procedurat e Azilit (APR) në një fazë të hershme, Komisioni Evropian paraqiti dy propozime mbi konceptet e vendeve të sigurta, një listë evropiane të vendeve të sigurta të origjinës dhe rregulla të reja për lehtësimin e zbatimit të konceptit të vendit të tretë të sigurt në prill dhe në maj të vitit 2025. Propozimi i parë synonte zbatimin e parakohshëm të dispozitave të APR-së, sipas të cilave kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare nga shtetas të vendeve me një shkallë njohjeje në nivel BE-je prej 20% ose më pak mund të trajtohen në bazë të procedurës së përsheptuar ose procedurës në kufi. Propozimi sugjeronte gjithashtu që vendet e sigurta të origjinës dhe vendet e treta të sigurta të mund të përcaktohen me përjashtime.

Propozimi i dytë kishte të bënte me zbatimin e konceptit të vendit të tretë të sigurt. Ai synonte përsheptimin e procedurave të azilit dhe zvogëlimin e barrës mbi sistemet e azilit, duke ruajtur garancitë ligjore për kërkuesit. Ndryshimet e propozuara hoqën detyrimin që kërkuesi të kishte një lidhje me vendin e tretë të sigurt, duke parashikuar se kalimi transit përmes një vendi të tretë të sigurt përbënte lidhje të mjaftueshme midis kërkuesit dhe atij vendi, si dhe përfshinë mundësinë e zbatimit të konceptit edhe nëse kërkuesi nuk ka asnjë lidhje me vendin e sigurt ose nuk ka kaluar transit përmes tij, kur ekziston një marrëveshje apo një ujdj e veçantë me vendin e tretë për këtë qëllim.

Në shkurt të vitit 2026, Parlamenti Evropian dha dritën jeshile për rregullat e reja dhe Këshilli rishikoi zyrtarisht konceptin e vendit të tretë të sigurt dhe miratoi listën e parë të përbashkët në nivel BE-je të vendeve të sigurta të origjinës, duke përfshirë Bangladeshin, Kolumbinë, Egjiptin, Indinë, Kosovën,¹ Marokun dhe Tunizinë.

Për të plotësuar kuadrin legjislativ të Paktit, në mars të vitit 2025, Komisioni Evropian propozoi modernizimin e politikës evropiane për kthimet përmes një Sistemi të ri të Përbashkët Evropian për Kthimet. [Rregullorja](#) parashikon procedura të përbashkëta në shtetet anëtare për marrjen e vendimeve të kthimit dhe një Urdhër të vetëm Evropian për Kthimet, i cili do të nxisë uniformitetin, transparencën dhe koordinimin. Në nëntor të vitit 2025, Komisioni Evropian nisi Ciklin e parë Vjetor të Menaxhimit të Migracionit, që përfshin:

¹ Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë të Kosovës.



- Raportin Vjetor Evropian për Azilin dhe Migracionin (EAAMR), që jep një panoramë të gjendjes së azilit dhe migracionit në BE:
- Vendimet e Komisionit Evropian për përcaktimin e nivelit të presionit nga flukset migratore në shtetet anëtare; dhe
- Propozimin e Komisionit Evropian për një Fond Solidariteti për adresimin e nevojave të shteteve anëtare nën presion.

Sipas EAAMR-së, që mbulon periudhën korrik 2024 - qershor 2025, gjendja e migracionit në BE ka pasur përmirësim, por ka ende sfida të tilla si presioni i vazhdueshëm nga mbërritjet e parregullta, lëvizjet e paautorizuara brenda BE-së dhe përdorimi i migracionit si mjet presioni nga Rusia dhe Bjellorusia.

Bazuar në analizën e situatës që parashtrohet në raport, Komisioni Evropian konstatoi se Qiproja, Greqia, Italia dhe Spanja ndodhen nën “presion nga prurjet migratore” dhe kualifikohen për akses në Fondin e Solidaritetit të BE-së me hyrjen në zbatim të Paktit në qershor të vitit 2026. Një tjetër grup vendesh, ku përfshihen Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Gjermania, Estonia, Finlanda, Franca, Irlanda, Letonia, Lituania, Holanda dhe Polonia, u identifikuan si “në rrezik presioni nga prurjet migratore”. Së fundi, Austria, Bullgaria, Kroacia, Çekia, Estonia dhe Polonia u identifikuan si “vende që po përballen me një situatë të ngarkuar migratore” për shkak të presionit të akumuluar gjatë 5 viteve të fundit. Vendimi Zbatues i Komisionit për krijimin e Fondit vjetor të Solidaritetit përcaktoi se në vitin 2026 do të nevojiteshin 21 000 zhvendosje ose kontribute financiare në një vlerë prej 420 milionë euro, me datë të nisjes së zbatimit 12 qershor 2026.

Për të përcaktuar objektivat politike të BE-së për azilin dhe migracionin për vitet në vazhdim, në janar të vitit 2026, Komisioni Evropian prezantoi një Strategji Evropiane për Menaxhimin e Azilit dhe të Migracionit. Kjo strategji shërben si një busull për ndjekjen e tre objektive kryesore të parandalimit të migracionit të jashtëligjshëm, mbrojtjes së njerëzve që largohen nga lufta dhe persekutimi dhe tërheqjes së talentëve drejt BE-së.

Për sa i përket dimensionit të jashtëm të politikës për migracionin dhe azilin, BE-ja ka vijuar të ndjekë një qasje menaxhimi migracioni të fokusuar tek i gjithë rrugëtimi migrator (whole-of-route) përmes koordinimit me aktorë të ndryshëm. Nismat përfshinin adresimin e shkaqeve rrënjësore të migracionit, ndihmën ndaj shteteve partnere për rritjen e kapaciteteve të tyre për të menaxhuar kufijtë dhe për të luftuar rrjetet e kontrabandës, kontributin në zgjidhje për mbrojtjen e personave të zhvendosur në pjesë të ndryshme të botës dhe ofrimin e rrugëve të sigurta dhe të ligjshme të kalimit për në Evropë, si alternativë ndaj migracionit të parregullt. Përveç bashkëpunimit të bazuar në stimuj pozitivë, BE-ja ka përfshirë edhe mundësinë e tërheqjes së përfitimeve në situata të jashtëzakonshme kur marrëveshjet ekzistuese përdoren në mënyra që krijojnë sfida të konsiderueshme për sa i përket migracionit dhe sigurisë. Për këtë qëllim, ka hyrë në fuqi një rregullore e re që parashikon një mekanizëm të rishikuar të pezullimit të vizave.



Menaxhimi i aksesit në mbrojtjen ndërkombëtare



Në vitin 2025, numri i kërkesave për azil të depozituara në vendet e BE+ pësoi rënie për të dytin vit radhazi, duke arritur në 822 000 (*shihni Figurën 1*). Kjo përfaqëson një rënie me një të pestat krahasuar me vitin 2024, duke shënuar totalin më të ulët që prej vitit 2021. Gjermania ka vijuar të jetë vendi kryesor marrës (me 163 000 kërkesa), ndonëse në një nivel shumë më të ulët krahasuar me vitin 2024 (me një rënie prej pothuajse një të tretat), pasuar nga Franca (152 000), Spanja (143 000) dhe Italia (134 000).

Për sa u përket kërkesave për azil në raport me madhësinë e popullsisë, në vendet e BE+ janë depozituar mesatarisht rreth 1800 kërkesa për çdo 1 milion banorë. Greqia dhe Qipro patën numrin më të lartë të kërkuessve për çdo 1 milion banorë (përkatësisht 5900 dhe 4500). Ato pasoheshin, me një diferencë të konsiderueshme, nga Spanja, Belgjika dhe Zvicra (me pothuajse 2900 secila).


Kërkesat në vitin 2025 ishin të përqendruara në një numër të kufizuar kombësish. Pesë grupet më të mëdha ishin shtetas të Afganistanit (14% e të gjitha kërkesave), Venezuelës (11%), Sirisë (5%), Bangladeshit (4%) dhe Turqisë (4%).

Numri i kërkesave të përsëritura u rrit me 39% krahasuar me vitin 2024, duke arritur një nivel rekord. Ato përfaqësonin 15% të të gjitha kërkesave për azil në vitin 2025, përqindja më e lartë e shënuar ndonjëherë. Kjo mund t'i atribuohet një [vendimi të GjDBE-së](#) të tetorit të vitit 2024, sipas të cilit gjinia dhe kombësia ishin të mjaftueshme që gratë afgane të konsideroheshin në rrezik persekutimi, gjë që çoi në një rritje të kërkesave të përsëritura nga afganët.

Shtetasit e vendeve me shkallë të ulëta njohjeje depozituan një numër gjithnjë e më të lartë kërkesash në vitin 2025, duke përfaqësuar mbi gjysmën e numrit total të kërkesave. Në bazë të rregullave të Paktit, duke nisur nga qershori i vitit 2026, në rrethana të caktuara të specifikuara në nenin 43, paragrafi 1 të APR-së, shtetasit e vendeve me shkallë të ulëta njohjeje (nën 20%) do t'i nënshtrohen procedurës së detyrueshme në kufi.

Përgjatë vitit, vendet e BE+ bashkëpunuan me Komisionin Evropian dhe agjencitë e BE-së për të modernizuar kapacitetet e TI-së në kufij, duke përfshirë sigurimin e burimeve teknike, operacionale dhe administrative për funksionimin e sistemit të ri Eurodac. Për t'u përgatitur për funksionimin pa probleme dhe të harmonizuar të ekzaminimit, procedurës kufitare të azilit dhe procedurës kufitare të kthimit, autoritetet kombëtare vijuan punën legislative dhe përgatitjet praktike, ndër të tjera përmes ngritjes së infrastrukturës së nevojshme, sigurimit të kapacitetit të mjaftueshëm, zhvillimit të udhëzimeve dhe mjeteve praktike dhe ofrimit të trajnimit për profesionistët që do të zbatojnë procedurat e reja.



Figura 1. Numri i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare në vendet e BE+, 2015-2025

Burimi: Të dhënat e EPS-së së EUAA-së deri në datën 3 shkurt 2026.

Si përgjigje ndaj presioneve të përziera migratore dhe sfidave të sigurisë në kufijtë e jashtëm, vendet e BE+ vijuan të fokusoheshin në menaxhimin e kufijve dhe të zbatonin regjime më të rrepta mbrojtjeje, duke rrezikuar në disa raste aksesin efektiv në territor dhe procedurën e azilit për personat që mund të kenë nevojë për mbrojtje. Këto praktika janë kritikuar shpeshherë nga organizatat ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile, si dhe nga institucionet gjyqësore, të cilat kanë trajtuar raste të raportuara të keqtrajtimit, pretendime për kthime të detyruara dhe kthime pa një proces të rregullt, si dhe masa të marra nga autoritetet kombëtare kundër organizatave të shoqërisë civile që kryejnë aktivitete kërkim-shpëtimi.

Nismat për procedura azili më të thjeshtuara dhe të harmonizuara



Për sa u përket procedurave të azilit, aktivitetet nga vendet e BE+ u fokusuan në tre fusha kryesore: ulja e numrit të rasteve në pritje të një vendimi, alokimi i kapaciteteve për sigurimin e zbatimit të rregullave të reja në praktikë dhe trajnimi i stafit mbi dispozitat e reja. Gjithashtu, Komisioni Evropian vuri në dispozicion mbështetje financiare (siç është Instrumenti i Mbështetjes Teknike (TSI)), EUAA ofroi mbështetje teknike dhe vendet e BE+ u angazhuan në bashkëpunime dypalëshe për shkëmbimin e përvojave. Në përputhje me kërkesat e Paktit, ato alokuan gjithashtu burime të konsiderueshme për hartimin e planeve kombëtare të emergjencës për skenarë të ndryshëm, duke përfshirë tregues dhe kufij për aktivizimin dhe çaktivizimin e masave specifike të reagimit.

Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve u përshtatën sipas situatës unike të çdo vendi për sa i përket azilit dhe pritjes. Disa vende vijuan të fokusoheshin në ndryshimet organizative, rekrutimi i stafit dhe aktivitetet e trajnimit për zhvillimin e aftësive. Disa autoritete të azilit kanë vijuar të rishikojnë apo të përmirësojnë procedurat e brendshme dhe të përditësojnë modelet dhe projekt-vendimet me objektivin për të rritur efikasitetin e proceseve të tyre



vendimmarrëse. Për të mbështetur një vendimmarrje cilësore dhe të shpejtë, vendet e BE+ përditësuan politika specifike kombëtare duke u bazuar te ndryshimet në vendet e origjinës. Megjithatë, situata e paqëndrueshme në disa vende origjine ka ndikuar në trajtimin e rasteve dhe, ndonjëherë, autoritetet e azilit kanë pezulluar trajtimin e rasteve të shtetasve nga vende të ndryshme origjine.

Në vitin 2025, vendet e BE+ shpallën rreth 874 000 vendime të shkallës së parë, duke shënuar numrin më të lartë që nga viti 2017. Rritja u nxit nga një shtim i ndjeshëm i numrit të refuzimeve, kryesisht për shtetasit e vendeve me një shkallë të ulët njohjeje (20% ose më pak). Shumica e vendimeve u shpallën në Gjermani, pasur nga Franca dhe Spanja. Numri i rasteve ende në shqyrtim në shkallë të parë u ul në 863 000 në vitin 2025, krahasuar me 986 000 në vitin 2024 (një rënie me pothuajse 13%). Ndonëse disa vende të BE+ e përshpejtuan vendimmarrjen në shkallë të parë, rënia e numrit të rasteve në shqyrtim ka ardhur më tepër si pasojë e uljes së numrit të kërkesave të depozituara. Pavarësisht rënies së numrit të rasteve në shqyrtim në shkallën e parë, rritja e numrit të apelimeve bëri që ngarkesa të mbetjet e qëndrueshme dhe e lartë në të gjitha shkallët.

Duke qenë se Komisioni Evropian theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me organet gjyqësore dhe fuqizimit të tyre për t'u përgatitur për aktivizimin e rregullave të Paktit, një sërë vendesh të BE+ investuan në rritjen e kapaciteteve në shkallën e dytë ose në shkallët më të larta.

Pritja e kërkesve për mbrojtje ndërkombëtare



Vendet e BE+ kanë punuar për transpozimin e Direktivës së vitit 2024 për Kushtet e Pritjes (RCD) në legjislacionin e brendshëm brenda datës 12 qershor 2026, si dhe për përshtatjen me rregullore të tjera që ndikojnë te pritja, siç është Rregullorja për Menaxhimin e Azilit dhe Migracionit (AMMR) dhe APR. Nën udhëheqjen e planeve të tyre kombëtare të zbatimit, vendet e BE+ kanë përshtatur kushtet e pritjes dhe kanë adresuar mangësitë në kapacitetet e pritjes, duke përfshirë ato për kërkesit në procedurën në kufi. Në këtë drejtim, shumë vendeve iu desh të ngrinin qendra për ekzaminimin dhe struktura akomodimi për kërkesit që i nënshtrohen procedurës në kufi. Nevojat operationale nxitën gjithashtu ndryshime në menaxhimin e rasteve dhe në sistemet e TI-së. Raundi i parë i Ciklit Vjetor të Menaxhimit të Migracionit kontribuoi në të dhëna më cilësore mbi sistemet e pritjes në të gjitha vendet e BE+.

Rënia e numrit të kërkesave për azil çoi në reduktim të barrës mbi sistemet e pritjes në disa vende, të cilat më pas reduktuan kapacitetet e tyre të pritjes. Ndërkohë, disa vende ku sistemet e pritjes vazhduan të përballen me ngarkesa të mëdha, i ruajtën ose i rritën kapacitetet e tyre. Në një çështje emblematike lidhur me kapacitetet e pritjes, GjDBE-ja u shpreh se një shtet anëtar nuk mund të përdorë justifikimin se ka pasur një fluks të paparashikueshëm dhe të pashmangshëm kërkesish për të shmangur detyrimet e tij në bazë të së drejtës së BE-së për të plotësuar nevojat bazë të azilkërkesve, duke theksuar nevojën për kapacitete rezervë për përballimin e flukseve të mundshme të kërkesve.

Vendet e BE+ kanë kohë që përballen me ndikimin e lëvizjeve dytësore. Disa prej tyre kanë vazhduar nismat ekzistuese apo kanë lançuar nisma të reja për të adresuar këtë dukuri, si për



shembull duke bërë ndryshime në kushtet e pritjes, në përputhje me nenin 21 të RCD-së (2024) dhe nenin 18 të AMMR-së. Këto dispozita parashikojnë se kërkuesit që janë njoftuar për një vendim transferimi në shtetin anëtar përgjegjës nuk kanë më të drejtë për kushte pritjeje, por vazhdojnë të kenë të drejtën për një standard jetese në përputhje me të drejtën e BE-së.


Përgjegjësia për një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare



Në vitin 2025, në vendet e BE+ janë kryer në total 18 000 transferime në kuadër të procedurës Dublin, shifër kjo e ngjashme me atë të vitit 2024 (*shihni Figurën 2*). Kjo shënon shifrën e dytë më të lartë që prej vitit 2019, ndonëse mbetet ende shumë më poshtë niveleve të regjistruara para pandemisë.

Zbatimi i transferimeve në kuadër të procedurës Dublin ka vazhduar të ndikohet së tepërmi nga presionet mbi sistemet e pritjes në disa vende të BE+. Ndonëse gjykatat kombëtare në përgjithësi i kanë konfirmuar transferimet, një prej arsyeve kryesore të rrezimit të vendimeve të autoriteteve kombëtare ishte ekzistenca e provave për probleme serioze lidhur me mohimin e aksesit në kushtet e pritjes në shtetin përgjegjës.

Figura 2. Numri i transferimeve të realizuara nga totali i kërkesave të pranuar në kuadër të procedurës Dublin, 2025



Burimi: Të dhënat e EPS-së së EUAA-së deri në datën 3 shkurt 2026.

Vendet e BE+ u fokusuan në kalimin nga zbatimi i Rregullores Dublin III te Rregullorja e re Eurodac dhe tek AMMR. Gjatë vitit u sqaruan disa paqartësi ligjore dhe praktike, ndërsa disa çështje të tjera mbetën pezull deri në miratimin zyrtar të Vendimit Zbatues për krijimin e



Fondit vjetor të Solidaritetit për vitin 2026, më 19 dhjetor 2025. Ndonëse disa autoritete kombëtare preferuan të prisnin për sqarime në mënyrë që të mund të zhvillonin një plan zbatimi më të detajuar, shumica e administratave nisën një planifikim të bazuar në skenarë të ndryshëm.

Njësitë Dublin bënë përpjekje të koordinuara për të reduktuar numrin e çështjeve të tyre të mbartura, në mënyrë që të shmangej sa më shumë përdorimi i njëkohshëm i rregullave të vjetra dhe atyre të reja pas hyrjes në fuqi të Paktit. Megjithatë, pamjaftueshmëria e stafit në njësitë Dublin vazhdoi të ishte problem. Për më tepër, menaxhimi i çështjeve ekzistuese paralelisht me kryerjen e trajnimit ishte mjaft sfidues për një pjesë të madhe të stafit të njërive Dublin. Disa autoritete theksuan se kishte edhe aktorë të tjerë jashtë njërive Dublin të cilët kishin gjithashtu nevojë për trajnim të posaçëm për të kuptuar rregullat e reja dhe për t'i informuar saktë kërkuesit në lidhje me procedurën.

Një sfidë madhore për vendet e BE+ në procesin e tranzicionit ishte përshtatja e sistemeve të TI-së, duke përfshirë rikonfigurimin e sistemeve të menaxhimit të rasteve për të përfshirë forma, modele dhe flukse pune të reja. Në disa vende, projektet e TI-së të lidhura me zbatimin e Eurodac dhe të AMMR-së janë pjesë e një programi më të gjerë dixhitalizimi.

Në vitin 2025, sipas të dhënave paraprake të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe Gatishmërisë (EPS) të EUAA-së, u morën 120 000 vendime për kërkesat dalëse në kuadër të procedurës Dublin. Kjo përfaqësonte një rënie me 24% krahasuar me vitin 2024 dhe nivelin më të ulët të shënuar që prej vitit 2021. Kjo rënie sugjeron një reduktim të lëvizjeve dytësore, ku azilkërkuesit lëvizin nga vendi i parë i mbërritjes drejt një vendi tjetër për të paraqitur një kërkesë të re, dhe është në një linjë me rënien e përgjithshme të numrit të kërkesave për azil.

Qasja e harmonizuar për risistemimin dhe pranimin për motive humanitare



Kufizimet politike, operacionale dhe financiare kufizuan zhvillimet në fushën e risistemimeve dhe pranimit për motive humanitare gjatë vitit 2025. Faktorët që u bënë pengesë për risistemimin e kërkuesve përfshinin:

- çështje të lidhura me zbatimin e dispozitave të Paktit në nivel teknik, si ruajtja dhe transferimi i të dhënave duke përdorur procese që janë në përputhje me rregulloren Eurodac;
- situata e paqëndrueshme politike dhe e sigurisë në Lindjen e Mesme, e cila krijoi sfida në nivel operacional; dhe
- mbingarkesa e vazhdueshme e disa sistemeve të pritjes në vendet e BE+, e cila kufizoi kapacitetin e tyre për të pritur refugjatë të risistemuar.

Si rrjedhojë, nga një total prej 61 000 zotimesh të bëra nga 14 shtete në kuadër të skemës së BE-së për Risistemimin dhe Pranimin për Motive Humanitare 2024-2025, gjatë vitit 2025, në vendet e BE+ mbërritën jo më shumë se rreth 10 000 refugjatë, krahas afro 14 000 të tjerëve në vitin 2024. Pas 10 vitesh gjatë të cilave sirianët përbënin numrin më të madh të të risistemuarve, afganët (2900) u renditën të parët në vitin 2025, pasuar nga sirianët (1800), kongolezët (1600) dhe sudanezët (1400).



Në dhjetor të vitit 2025, Këshilli miratoi Planin e parë Dyvjeçar të BE-së për Risistemimin dhe Pranimin për Motive Humanitare për periudhën 2026-2027. Nëntë vende parashtuan angazhimet e tyre për një total prej 10 430 rastesh, ku përfshihen 8330 risistemime dhe 2100 pranime për motive humanitare. Rënia e theksuar e angazhimeve kombëtare pasqyroi rënie e përgjithshme të numrit të pranimeve në nivel BE-je.

Të drejtat e përfituesve të mbrojtjes ndërkombëtare për përfshirje dhe riintegrim



Përmbajtja e mbrojtjes u referohet të drejtave që përfituesit e një forme të mbrojtjes gëzojnë në vendin e azilit, si dhe detyrimeve përkatëse. Mbrojtja jepet kur merret një vendim pozitiv për dhënien e statusit të refugjatit ose mbrojtjes plotësuese për kërkuesit (referuar edhe si statuset e harmonizuara me BE-në). Shkalla e njohjes i referohet përqindjes së rezultateve pozitive në numrin total të vendimeve lidhur me kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare. Ndonëse format kombëtare të mbrojtjes u japin një status mbrojtjeje shtetasve të vendeve të treta, ato statuset që nuk janë të harmonizuara nëpër vendet e BE+ përjashtohen zakonisht nga llogaritja e shkallës së njohjes.

Në vitin 2025, shkalla e njohjes për mbrojtjen ndërkombëtare ra ndjeshëm, nga 42% në vitin 2024 në 29%. Kjo rënie ka gjasa të ketë qenë, të paktën pjesërisht, rezultat i pezullimit të vendimmarrjes për kërkuesit sirianë, të cilëve u ishte atribuuar një pjesë e madhe e vendimeve pozitive gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, rreth 56% e vendimeve kishin të bënin me shtetas të vendeve me një shkallë të ulët njohjeje. Për sa u përket 69 shtetësive për të cilat në vitin 2025 u dhanë të paktën 1000 vendime, 42 prej tyre patën një shkallë njohjeje prej më pak se 20%.

Shtetasve të Turqisë, Venezuelës, Bangladeshit dhe Kolumbisë (në rend zbritës) iu atribuuar një e treta e të gjitha vendimeve negative. Megjithatë, venezuelasve dhe kolumbianëve iu ofrua në shumë raste një formë kombëtare mbrojtjeje ose iu lejua qëndrimi në një formë tjetër. Shkallët e njohjes ishin të larta për shtetasit nga vende me nivel ekstrem dhe të lartë konfliktesh, duke variuar nga 70% në 90% për kërkuesit nga Sudani, Mali, Haiti, Ukraina dhe Mianmari/Burma (në rend zbritës).

Vendet e BE+ kanë vazhduar të kufizojnë numrin e mbërritjeve përmes bashkimit familjar, si një mënyrë për të lehtësuar presionin mbi sistemet e azilit dhe të pritjes, dhe ndonjëherë edhe mbi sistemet sociale kombëtare dhe vendore. Gjatë viteve të fundit, UNHCR, organizata të tjera ndërkombëtare, institutet kërkimore, academia dhe organizatat e shoqërisë civile kanë paralajmëruar vazhdimisht në lidhje me ndikimin negativ që mund të ketë rreptësimi i rregullave të bashkimit familjar tek integrimi i përfituesve të mbrojtjes ndërkombëtare.

Vendet e BE+ kanë vijuar të fokusohen tek integrimi i përfituesve përmes shpalljes së strategjive dhe masave të reja për aksesin në tregun e punës dhe në arsim. Pavarësisht këtyre nismave, përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare kanë vazhduar të përballen me pengesa në vendet e BE+ gjatë përpjekjeve për të mësuar gjuhën, për t'u regjistruar në arsim apo për të kërkuar punë, ndërsa sfidat lidhur me aksesin në banesa kanë vazhduar të ndikojnë negativisht në perspektivat e integritimit. Organizatat e shoqërisë civile kanë vijuar të luajnë një rol kyç në integrimin efektiv të përfituesve, duke ofruar një gamë shërbimesh për këtë qëllim.




Kutia 1. Mbrojtja e përkohshme për personat e zhvendosur nga Ukraina



Në fund të vitit 2025, rreth 4,5 milionë individë gëzonin mbrojtje të përkohshme në vendet e BE+. Kjo shifër ka mbetur relativisht e pandryshuar që prej fillimit të vitit 2023 dhe vijon të kontribuojë ndjeshëm në numrin e përgjithshëm të njerëzve në Evropë me nevoja për mbrojtje. Në raport me numrin e popullsisë, Çekia, Polonia dhe Sllovakia kanë pritur numrin më të madh të Ukrainasve të zhvendosur për frymë (shihni Figurën 3).

Figura 3. Numri i personave që gëzojnë mbrojtje të përkohshme për çdo 1 milion banorë sipas vendit pritës, dhjetor 2025



Shënim: * = Të dhëna të nxjerra përpara shkurtit të vitit 2026

Burimi: Numrat e popullsisë: Eurostat (DEMO_GIND), nxjerrë më 5 shkurt 2026. Përfituesit e mbrojtjes së përkohshme: Eurostat (MIGR_ASYTPSM), nxjerrë më 10 shkurt 2026.

Për të katërtin vit që pas pushimit rus, vendet e BE+ vijuan t'i orientonin politikat e tyre drejt zgjidhjeve afatgjata, si ofrimi i mundësive për kalimin në një leje alternative kombëtare qëndrimi. Paralelisht, ato vazhdojnë të nxisin integrimin në shumë nivele, duke përfshirë atë në tregun e punës dhe në arsim. “Unity Hubs”, të ngritura në një sërë vendesh të BE+, ofrojnë ndihmë për punësimin, kurse gjuhe, këshillim për përfituesit dhe, në disa raste, mbështetje për kthimet vullnetare.

Zhvillimet jurisprudenciale si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel BE-je, sqaruan më tej ndërveprimin midis mbrojtjes së përkohshme dhe procedurave të mbrojtjes ndërkombëtare.




Masat mbrojtëse ligjore për fëmijët dhe kërkuesit me nevoja të veçanta



Për të rritur mbrojtjen e personave me nevoja të veçanta, Pakti përfshin masa për një identifikim më të shpejtë dhe mbështetje për adresimin e nevojave të tyre procedurale dhe të pritjes. Një sfidë kryesore për vendet e BE+ mbetet operacionalizimi i këtyre masave mbrojtëse. Për të rritur kapacitetet në këtë fushë, në vitin 2025, autoritetet kombëtare ofruan trajnim për aktorë të ndryshëm dhe përmirësuan sistemet e informacionit për të lehtësuar bashkëpunimin midis profesionistëve të ndryshëm të përfshirë në proces.

Në vitin 2025, u paraqitën 22 000 kërkesa për azil nga të mitur të vetëshpallur si të pashoqëruar, duke shënuar një rënie me një të tretat krahasuar me vitin 2024 dhe nivelin më të ulët që prej vitit 2020. Pavarësisht se shënoi rënien më të madhe në shifra absolute, Gjermania vazhdoi të merrte numrin më të madh të kërkesave (4100 kërkesa), duke përfaqësuar pothuajse një të pestën e totalit (*shihni Figurën 4*). Gjermania u pasua nga Holanda (3600), Italia (3400) dhe Greqia (3100). Pesë shtetësi përbënin më shumë se gjysmën e të gjitha kërkesave për azil të paraqitura nga të mitur të pashoqëruar në vitin 2025, konkretisht afghanët (2800), eritreanët (2400), egjiptianët (2300), somalezët (2300) dhe sirianët (2100, numri më i ulët i regjistruar ndonjëherë).

Figura 4. 10 vendet kryesore të BE+ me numrin më të madh të kërkesave nga të miturit e vetëshpallur si të pashoqëruar për vitin 2025 krahasuar me vitin 2024, si dhe numri i kërkesave të depozituara nga shtetësitë kryesore të të miturve të pashoqëruar për vitin 2025



Burimi: Të dhënat e EPS-së së EUAA-së deri në datën 3 shkurt 2026.



Autoritetet e azilit vijuan të rishikojnë ligjet dhe politikat e tyre drejt një vlerësimi shumëdisiplinar të moshës, sipas kërkesave të APR-së dhe në përputhje me [udhëzuesin praktik](#) të EUAA-së të botuar në vitin 2025. Disa vende të BE+ u përballën me një numër të pamjaftueshëm kujdestarësh ligjorë që mund të caktoheshin për mbështetjen dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve të pashoqëruar. Projekti GuardianXChange, i financuar nga BE-ja, vazhdoi të forconte shërbimet e kujdestarisë në katër vendet pjesëmarrëse të BE+, konkretisht Belgjikë, Poloni, Portugali dhe Slloveni.

Me Direktivën e rishikuar të BE-së kundër Trafikimit, e cila do të transpozohet brenda korrikut të vitit 2026, shtetet anëtare të BE-së zbatuan projekte dhe aktivitete të ndryshme trajnimi për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe identifikimin më të mirë të viktimave. Që pas paraqitjes së propozimeve të Paktit, disa aktorë shprehën shqetësime lidhur me ndikimin e mundshëm negativ të ndryshimeve të kërkuarit me nevoja të veçanta në procedurën e azilit. Duke qenë se procesi legjislativ është ende në zhvillim në nivel kombëtar, këto shqetësime janë rishfaqur shpesh në kontekstin kombëtar në formën e komenteve mbi propozimet ligjore.

Pavarësisht përpjekjeve për të mbështetur më mirë kërkuarit me nevoja të veçanta në kontekstin e pritjes, në disa vende të BE+ janë raportuar kushte të papërshtatshme dhe mbështetje e pamjaftueshme, për shembull për shkak të mungesës së burimeve ose mangësive dhe vonesave në financim. Shqetësimet në lidhje me ndalimin e personave me nevoja të veçanta, veçanërisht fëmijëve, vijuan të ngriheshin, të dokumentoheshin në vendime gjyqësore dhe të raportoheshin nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile. Në disa çështje gjyqësore, u analizuan edhe nevojat e veçanta dhe cenueshmëritë në kontekstin e transferimeve dhe kthimeve në kuadër të procedurës Dublin.



Vërejtjet përfundimtare

Viti i kaluar u karakterizua nga përgatitje intensive për operacionalizimin e Paktit për Migracionin dhe Azilin brenda qershorit të vitit 2026. Si EUAA-ja, ashtu edhe autoritetet kombëtare, investuan burime të konsiderueshme për të hedhur bazat për kuadrin e ri për menaxhimin e sistemit evropian të mbrojtjes.

Për këtë qëllim, vendet e BE+ bënë alokime financiare të konsiderueshme dhe përshpejtuan procedurat e prokurimit për të garantuar që sistemi i Eurodac të vihej në funksionim në kohën e duhur. Në vijim të nismave të ndërmarra vitet e fundit për rekrutimin e stafit, autoritetet kombëtare të azilit u fokusuan në reduktimin e rasteve ende të pazgjdhura për të shmangur sa më shumë përdorimin e njëkohshëm të kuadrove të ndryshme legjislative pas qershorit të vitit 2026. Disa vende investuan në ngritjen e qendrave shumëfunksionale, ku ekzaminimi, procedura kufitare e azilit dhe procedura kufitare e kthimit mund të kryhen në të njëjtin vend.

EUAA-ja i mbështeti vendet e BE+ në këto përpjekje në sajë të aktiviteteve të ndryshme. Agjencia zhvilloi udhëzime dhe mjete për procedurat e reja, përditësoi udhëzuesit ekzistues dhe trajnoi profesionistët e administratave kombëtare lidhur me dispozitat e Paktit. Në 12 vende, Agjencia ofroi mbështetje operationale të drejtpërdrejtë. Në nivel BE-je, Agjencia analizoi zhvillimet e reja dhe ofroi me shpejtësi përditësime sipas situatave për të mbështetur Komisionin Evropian në udhëheqjen e proceseve të reagimit dhe për të informuar më mirë politikëbërësit në nivel kombëtar.

Kryerja e këtyre përgatitjeve u bë disi më e lehtë falë rënies së numrit të kërkesave në 822 000 në vitin 2025, shifër e cila shënon nivelin më të ulët që prej vitit 2021. Kjo i lejoi autoritetet kombëtare të fokusonin më shumë burime në zhvillimin e flukseve të punës, procedurave standarde të operimit dhe modeleve të reja, si dhe në pilotimin e këtyre qasjeve të reja në kontekstin kombëtar.

Në vitin 2026, hyrja në zbatim e Paktit do të tregojë vlerën praktike të këtyre investimeve. Që pas miratimit të tij, aktorët kanë theksuar se suksesi i Paktit do të matet në bazë të kapacitetit të tij për të krijuar sisteme të qëndrueshme azili dhe pritjeje, të afta për t'u përshtatur me ndryshimet e shpejta nëpër botë. Viti 2026 do të sjellë në qendër të vëmendjes vlerën praktike dhe ndikimin e reformës së CEAS. Ai do të vërtetojë, për shembull, se deri në ç'shikallë reforma do të mundësojë një ndarje të barabartë të barrës midis shteteve anëtare.

Rregullat e reja do të testohen në situata urgjente, ndërsa sistemi duhet të mbetet fleksibël për të adresuar zhvillimet në nivel global, në nivel BE-je dhe në nivel kombëtar. Ndryshimi i dinamikave në sektorin politik, ekonomik dhe atë të sigurisë dhe krizat ndërkombëtare dhe luftërat kanë ndikuar te disponueshmëria e financimit humanitar dhe te mekanizmat për adresimin e zhvendosjeve në rang global. Nevojat për mbrojtje si pasojë e konflikteve, si lufta në Iran dhe ajo në Ukrainë, kanë gjasa të rriten, ndërsa alokimet financiare në nivel global po pakësohen.

Në një kontekst ndërvarësish komplekse globale, Evropa është angazhuar në mënyrë proaktive dhe ka krijuar partneritete me vende të treta për të ngritur kapacitete për ofrimin e mbrojtjes efektive dhe për të adresuar migracionin e parregullt. Forcimi i kapaciteteve të vendeve partnere për menaxhimin e migracionit, duke respektuar plotësisht të drejtat themelore, mund të kontribuojë në zgjerimin e hapësirës globale të mbrojtjes.



Në nivel evropian, Strategjia e parë Evropiane për Azilin dhe Migracionin dikton drejtimin politik për 5 vitet e ardhshme. Me një fokus të theksuar te përmirësimi i kontrollit kufitar, vendosja e rregullave të rrepta kundër abuzimit me sistemet e azilit dhe kthimet e shpejta dhe efektive, kjo mund të sjellë një ulje të mëtejshme të numrit të kërkesave në vendet e BE+. Ndryshimet në Rregulloren për Procedurat e Azilit lidhur me konceptet e vendeve të sigurta dhe avancimi i Rregullores së re për Kthimet mund të kenë një efekt frenues të mbërritjet e reja. Megjithatë, në praktikë, ato mund edhe të kufizojnë aksesin në mbrojtjen ndërkombëtare për personat në nevojë.

Në nivel kombëtar, zbatimi në praktikë i Paktit dhe masat për rritjen e efektivitetit do t'i nënshtrohen një shqyrtimi të imtësishëm. Kjo pritet të përfshijë zbatimin e ekzaminimit, marrjen e vendimeve për papranueshmërinë për kërkuarit që kanë kaluar transit përmes një vendi të tretë ku mund të kishin kërkuar mbrojtje efektive, si dhe disa nga zgjidhjet dixhitale të propozuara për trajtim më efektiv të rasteve. Me zbatimin e Paktit, autoritetet kombëtare do t'i përshtasin sistemet e tyre në bazë të përvojave të para praktike. Në vitin 2026 priten kërkesa për sqarime juridike, numri i të cilave pritet të jetë edhe më i lartë në vitet në vazhdim, në nivelin e gjykatave kombëtare, GjEDNj-së dhe GjDBE-së.

Zhvillimet në kontekstin më të gjerë të rregullimit të migracionit - siç është vendimi i qeverisë spanjolle për një regularizim të jashtëzakonshëm të shtetasve të vendeve të treta me qëllim integrimin e tyre - do të ndikojnë gjithashtu te fluksi i punës i autoriteteve kombëtare të azilit dhe, kështu, tek operacionalizimi i Paktit. Për sa i përket të ardhmes së 4,5 milionë ukrainasve të regjistruar në bazë të Direktivës për Mbrojtjen e Përkohshme, disa vende kanë nisur të krijojnë mundësi kalimi nga mbrojtja e përkohshme të një lloji tjetër lejeje qëndrimi, duke hapur perspektiva të reja për qëndrimin e tyre në vendet e BE+. Kjo tendencë ka gjasa të bëhet edhe më e dukshme gjatë vitit 2026, teksa afron fundi i zgjatjes së regjimit të mbrojtjes së përkohshme në mars të vitit 2027.

Në këtë kontekst, vendet e BE+ kanë nevojë për informacion faktik të përditësuar për të përshtatur proceset e tyre në kohën e duhur. EUAA-ja luan një rol qendror në këtë drejtim përmes mekanizmave të saj të avancuar të monitorimit të situatës dhe rrjeteve të bashkëpunimit, të cilat ofrojnë një platformë për shkëmbimin e praktikave të mira dhe adresimin e sfidave. Gjatë vitit 2025, Agjencia mbështeti në mënyrë aktive vendet e BE+ në periudhën transitorë të operacionalizimit të Paktit, dhe mbetet e gatshme edhe në vitin 2026 e më tej për të ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë e për të ruajtur një dialog konstruktiv për krijimin e një mjedisi të përmirësuar të mbrojtjes në Evropë. Teksa aktorëve u duhet të navigojnë masat komplekse të Paktit dhe realitetet politike që ndryshojnë me shpejtësi, informacioni dhe angazhimi marrin një rëndësi edhe më të madhe për të ardhmen e CEAS.

Raporti për azilin, 2026: Përmbledhje ekzekutive

Si burimi kryesor i informacionit për mbrojtjen ndërkombëtare në Evropë, Raporti për azilin, 2026 ofron një panoramë gjithëpërfshirëse të zhvillimeve kryesore në fushën e azilit në vitin 2025. Përmbledhja ekzekutive është versioni i shkurtuar i raportit kryesor.

Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) mbledh informacione për të gjitha aspektet e Sistemit të Përbashkët Evropian për Azilin. Për këtë qëllim, raporti thekson tendencat kryesore të politikave, praktikave dhe legjislacionit lidhur me mbrojtjen ndërkombëtare dhe paraqet treguesit kryesorë për vitin referencë 2025. Shembujt e jurisprudencës janë paraqitur për të interpretuar legjislacionin evropian dhe kombëtar në kontekstin e *acquis* së BE-së për azilin.

Raporti për azilin, 2026 mbështetet në informacione nga një gamë e gjerë burimesh – duke përfshirë perspektivat nga autoritetet kombëtare, institucionet e BE-së, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile dhe bota akademike – për të përfshirë perspektiva të ndryshme. Raporti, i cili mbulon periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2025, shërben si referencë për zhvillimet më të fundit në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare në Evropë.